

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE
“ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY”

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është statuti i shoqërisë;
- “APD” është Autoriteti Portual Durrës.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe adresa e faqes së internetit

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 27. 07. 2022, Autoriteti Portual Durrës, ka krijuar një shoqëri aksionare me emrin **“ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY” SH.A** (“Shoqëria”).
- (2) Themelues i Shoqërisë është personi juridik publik Autoriteti Portual Durrës me NIPT J61811536L, me adresë Rruga “Tregtare”, Lagje Nr. 1, Durrës, Shqipëri, me adresë web www.durresport.al.

Neni 2

Objekti

(1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a. koordinimin dhe administrimin e proceseve të lidhura me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”;
- b. administrimin e pasurive dhe shërbimeve jashtë terminaleve në përdorim të Autoritetit Portual Durrës, si dhe çdo prone/ pasurie që mund ti kalohet në pronësi;
- c. përkujdesjen dhe zbatimin e rregullave të administrimit përsa i përket territoreve dhe ambienteve të APD-së jashtë zonave operacionale duke respektuar realizimin e detyrave, në rolin e APD-së si një “land lord port”;
- d. administrimin e tokës në gjithë hapësirat objekt i VKM nr. 861 datë 29.12.2021 “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Marina dhe jahtet e Durrësit (Durrës Yachts & Marina)”, e ndryshuar;

- c. administrimit e pronës në të gjitha pasuritë e paluajtshme aktuale dhe ato që mund të përfshohen nga Autoriteti Portual Durrës në të ardhmen në kuadër të projekteve të tij zhvillimore.
- (2) Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe finansiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 3

Selia

- (1) Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga "Tregtare", Lagje Nr. 1, Durrës, Shqipëri.
(2) Adresa e fakes së internetit të Shoqërisë është: _____
(3) Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka): _____

KREU II

Kapitali

Neni 4

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 10 000 000 (dhjetë milion) lekë, i ndarë në 1000 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10 000 (dhjetë mijë) lekë secili.
(2) Aksionet e themeluesit të vetëm, Autoriteti Portual Durrës, në kapitalin e shoqërisë janë 1000 (njëmijë) aksione.
(3) Kapitali i regjistruar përbëhet nga kontributi i aksionarit të vetëm, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milion) lekë. Kontributi është shlyer plotësisht.

Neni 5

Registri i aksioneve

- (1) Shoqëria mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit.
(2) Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e regjistrat të aksioneve të shoqërisë e detyrohen të lejojnë aksesin në informacionet e regjistrat ndaj çdo aksionari apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrat të aksioneve duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet.

Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 6 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve


- (1) Aksionet e Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë, në çastin e formimit të saj;
 - b) shitblerjes;
 - c) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- (2) Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj Shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban Shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të Ligjit.

Neni 7 Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi, kundrejt kontributeve të reja.
Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpara se t'u ofrohen aksionarëve të tjerë të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit.
- (2) Aksionari i vetëm mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga ky i fundit.
Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund të kryhet vetëm me vendim të aksionarit të vetëm.
- (3) Zmadhimi i kapitalit me aktivet e shoqërisë. Pas miratimit të bilancit të viti paraardhës, aksionari i vetëm mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpérndara.

Neni 8 Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- (1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të aksionarit të vetëm, në përputhje me përcaktimet e pikës 1 të nenit 145 të Ligjit.
- (2) Nëse zvogëlimi ndryshon të drejtat e një kategorie të caktuar aksionesh, vlefshmëria e tij kushtëzohet nga pëlgimi i aksionarëve përkatës, i cili duhet të përbushë kërkesat formale të pikës 3 të nenit 149 të Ligjit. Zvogëlimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe anulim aksionesh.
- (3) Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara në ligj, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.



KREU III
ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 9
Organet e shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Këshilli Mbikëqyrës;
3. Administratori.

Neni 10
Asambleja e Përgjithshme


(1) Autoriteti Portual Durrës me cilësinë e aksionerit të vetëm, ushtron të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të parashikuara nga Ligji që nuk janë shprehur në këtë Statut. Kompetencat e aksionerit të vetëm në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë realizohen nga Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, në përputhje me nenin 117/1/a dhe 135/4 të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 32/ç dhe 43 të ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Regjistrimin e biznesit” i ndryshuar.

(2) Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “d” të kësaj pike;
- f) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- g) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- h) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- k) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

(3) Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

(4) Aspekti administrativ i vendimmarrjes nga aksionari i vetëm do të kryhet në përputhje me ligjin nr.9130, dt.8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.



(5) Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- b) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

(6) Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 11 **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrës. Rastet e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme parashikohen nga Neni 136 i Ligjit.

(2) Nëse Asambleja e Përgjithshme thirret nga anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrës, thirrja kryhet nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës i dërgohen aksionarit të vetëm, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Neni 12 **Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Vendimet merren nga aksionari i vetëm i Shoqërisë.

(2) Administratori ose anëtarë i Këshillit të Mbikqyrës, pavarësisht se nuk është aksionar ka të drejtën e pjesëmarjes, si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14 **Këshilli Mbikëqyrës**

(1) Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga drejtuesit e Shoqërisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të jenë të punësuar në Shoqëri.

(2) Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me afat emërimi 3 (tre) vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës mund të rizgjidhen. Ata mund të revokohen nga Asambleja e Përgjithshme për shkaqe të parashikuara në Nenin 18 të këtij Statuti. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zëvendësohen nga Asambleja e Përgjithshme nëse ndryshon funksioni që përfaqësojnë.

(3) Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh, për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

(4) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 1 (një) këshill mbikëqyrës të shoqërive aksionare që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

(5) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të moshës mbi 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç nuk mund të jenë më shumë se 1/3 (një e treta) e numrit të përgjithshëm të këshillit mbikëqyrës. Nëse ky raport tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

(6) Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

(7) Këshilli Mbikëqyrës mund të ngarkojë një person si sekretar edhe jashtë anëtarëve të tij. Në rast mungese ose pengimi të kryctarit, mbledhjet e këshillit mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

(8) Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e Shoqërisë. Veprimet e administratorëve i nënshtrohen miratimit paraprak të Këshillit Mbikëqyrës, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 13 dhe në shkronjën "e" të nenit 154 (1) të Ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në këtë Statut.
- b. Këshilli Mbikëqyrës emëron Administratorin e Shoqërisë.
- c. Me emërimin e Administratorit, Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për detyrimet që rrjedhin në administrimin e Shoqërisë.
- d. Këshilli Mbikëqyrës autorizon administratorin që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në këtë Statut.
- e. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontolle, që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përbushjen e detyrës së tij.
- f. Administratori i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën një herë në tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, Administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli.
- g. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;
- h. të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- i. të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo Statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'u paraqitur Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të Këshillit Mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

- j. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Asamblesë së Përgjithshme lidhur me këto çështje:
- i) përcaktimin dhe ndyshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të Shoqërisë;
 - ii) kryerjen e investimeve dhe financimeve për vitin finanziar, si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - iii) hapjen e veprimtarive ose njësive të reja dhe ndryshimin e objektit të Shoqërisë;
- (9) Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 të nenit 136 të Ligjit, Këshilli Mbikëqyrës duhet të thërrasë menjëherë Asamblenë e Përgjithshme, për të shqyrtaur nëse Shoqëria duhet të prishet ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme.
- (10) Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga:
- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i APD-së;
 - Drejtori i Divizionit Juridik i APD-së;
 - Drejtori i Divizionit Financës dhe Administrimit;
 - Drejtori i Divizionit Teknik i APD-së;
 - Ekspert në çështjet portuale

- (11) Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të parë të Këshillit Mbikëqyrës deri në zgjedhjen e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme:
- Z. Pirro Vengu i ditëlindjes 24.04.1986, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I60424085M, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD-së;
 - Z. Aleks Marku i ditëlindjes 18.07.1980, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I00718074Q, në cilësinë e Drejtorit të Divizionit Juridik të APD-së;
 - Z. Alket Malo i ditëlindjes 24.02.1973, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H30224040D, në cilësinë e Drejtorit të Divizionit Financës dhe Administrimit;
 - Z. Rafaelo Rexho i ditëlindjes 05.07.1989, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I90705075O, në cilësinë e Drejtorit të Divizionit Teknik të APD-së;
 - Z. Andrea Shllaku i ditëlindjes 25.06.1991, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J10625145U, në cilësinë e ekspertit në çështjet portuale.

Neni 15

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe struktura e pagave të Shoqërisë

Këshilli Mbikëqyrës përcakton pagesën e anëtarëve, të kryetarit, të administratorit dhe strukturën e pagave të personelit të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 16

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës do të mbahen të paktën 1 (një) herë në 3 (tre) muaj, si dhe sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë.
- (2) Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me kuorumin e përcaktuar në pikën 5 të nenit 167 dhe nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.
- (3) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- (4) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës është njëloj i vlefshëm dhe i efektshëm sikur të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës ose të komitetit të Këshillit Mbikëqyrës, të mbledhur dhe të zhvilluar rregullisht.

Neni 17
Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve të mbledhjeve të tij.

Neni 18
Largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës


Detyra e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përsundon në rast se:

1. personi pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitave të Ligjit duke përfshirë parashikimet e pikës 4 të nenit 167 dhe nenit 157.
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrrëgullime mendore;
3. personi lirohet nga detyra që mban pranë Autoritetit Portual Durrës;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar shoqërinë, ose
5. ka munguar në më shumë se 2 (dy) mbledhje radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 19
Administratori

- 1) Këshilli Mbikëqyrës emëron Administratorin e Shoqërisë, për një afat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Emërimi prodhon pasoja pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administratori, gjatë ushtrimit të kësaj detyre në këtë Shoqëri, nuk mund të emërohet administrator në shoqëri të tjera tregtare.
 - 2) Administrator i parë i shoqërisë është z. Erlis Hereni shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.03.1985 mbajtës i kartës së identitetit me nr. 033812214 dhe numër personal I50318077K.
- (3) Administratori i shoqërisë ka të drejtë dhe detyrohet:
- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
 - b) të përfaqësojë Shoqërinë;
 - c) në marrëdhëniet me të tretët, Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e Administratorit, edhe kur këto e tejkalojnë objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, përvèç rastit, kur Shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit kapërcente objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe vepron me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund të injoroni këtë akt, duke pasur parasysh faktin se shpalija e Statutit nuk është provë e mjaftueshme.
 - d) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - e) të përgatisë dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
 - f) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm përrrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - g) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të Ligjit apo të ligjeve të tjera;
 - h) të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - i) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në Statut.
 - j) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
 - k) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare asfatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;
 - m) lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlerë mbi 20 (njëzet) milionë lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës.
 - n) marrëdhëniet brenda Shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
 - o) Administratori bën strukturën e organizimit të Shoqërisë dhe strukturën e pagave, e cila aprovohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhc miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 20
Shkarkimi i Administratorit të Shoqërisë



Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit, përfshirë shkarkimin nga Asambleja e Përgjithshme në pajtim me pikën 2 të nenit 167, dhe shkronjën "c" të pikës 2 të nenit 135 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njostuar shoqerinë, ose
4. ka munguar në më shumë se 2 (dy) mbledhje radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 21

Marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe Administratorit ose të një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet Shoqërisë dhe një anëtari të Këshillit Mbikëqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë duhet t'i nënshtronhet autorizimit paraprak të Këshillit Mbikëqyrës. Përcaktimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për marrëveshjet ndërmjet Shoqërisë dhe një shoqërie tjeter, kur një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës është dhe anëtar i këshillit mbikëqyrës të një shoqërie tjeter, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshje. Kjo nuk është e zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë rrjedhëse të shoqërisë që kryhet në kushte normale. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i interesuar duhet të njoftojë Këshillin Mbikëqyrës për një marrëveshje për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i interesuar i Këshillit Mbikëqyrës nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 22

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Përjashtmisht, ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar deri më 31 dhjetor.

Neni 23

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli i Shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga aksionari i vetëm dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Ekspert Kontabël i parë i caktuar nga aksionari themelues do të jetë shoqëria MAZARS sh.p.k me NIPT K32123006E dhe numër licence nr. 110, dt. 06.11.2006.

Kreu IV
Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 24
Inventari – llogari vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit, administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar. Administratori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 25
Dividendët

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit.
- (2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përsitimit të dividendift nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- (3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt Shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.
- (4) Çdo dividend që nuk është këruar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga Shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 26
Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.

Neni 27
Rezultati ushtrimor dhe përektimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferençë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, pasi të jenë zbritur humbjet e viti të mëparshëm. Nga fitimet e ushtrimit, të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme, hiqet të paktën 5% (pesë për qind) për të krijuar rezervën e domosdoshme. Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme nuk është e detyrueshme, kur kjo rezervë arrin 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon për një arsy qfarëdo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit.

Përdorimi i fitimit pas zbritjes së rezervës ligjore bëhet me urdhër të Ministrit përkatës.

Kreu V
Dispozita të fundit

Neni 28
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) ekzemplarë origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore, njeri prej te cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 29
Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente gjykata përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

AKSIONARI THEMELUES I SHOQËRISË

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

